REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr 2886 Prot Maliq, më 22.5.2026

PROJEKT VENDIM – NR.14

Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 19 datë 30.01.2026, "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq".

Bazuar në :
Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore* "i ndryshuar; Ligj nr. 57/2020 "*Për pyjet*"; Ligji nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkia Maliq*";
Udhëzimi nr. 1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*", VKB nr. 19 datë 30.01.2026 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq", Kërkesës për ndryshim sipërfaqe nr. 666 prot datë 04.03.2026 ;

I propozoj Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin për ndryshimin e sipërfaqes nga 20 m² në 100 m² për dhënien në përdorim në ngastrën nr. 39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë, Fshati Gurshqipe, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një Antene Telefonike nga kompania Vodafone Albania sh.a.
2. Ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për fillimin e procedurave për hartimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe 100 m² me objekt ngritjen e Antenës Telefonike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Bashkia Maliq nxjerr certifikatat e pronësisë të ngastrave që do jepen në përdorim dhe lidh kontratën e qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËN KRYETAR
Eridjon Rustemi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

6th Klm of National Road Tirana - Durres, Kashar, Tirana - Albania
Tel: +35544503717, Fax: +35544503714
Email: hellasservice-al@hsmsgroup.com

Datë: 04/03/2026

Prot. Nr.

HELLAS SERVICE Sh.p.k.
Nr. Prot. 0666

Drejtuar: Bashkisë Maliq

Në vëmendje të: Z. Gëzim Topçiu, Kryetar

Lënda: Kërkesë për ndryshim sipërfaqeje dhe amendim kontrate qiraje

Të nderuar Zotërinj.,

Në vijim të komunikimeve dhe kërkesës së paraqitur më parë nga shoqëria **"Hellas Servis" sh.p.k.**, në cilësinë e shoqërisë nënkontraktore të **Vodafone Albania**, lidhur me lidhjen e një kontrate qiraje për vendosjen e infrastrukturës së telekomunikacionit në zonën **Gurshqipe**, ju paraqesim sa më poshtë:

Gjatë përgatitjes së dokumentacionit teknik për pajisjen me **leje ndërtimi**, rezulton e nevojshme që sipërfaqja e kërkuar për realizimin e projektit të rishikohet. Për këtë arsye, kërkojmë që sipërfaqja e kërkuar për t`u dhënë me qira të ndryshohet nga **20 m² në 100 m²**, sipërfaqe e cila është e domosdoshme për realizimin e plotë të infrastrukturës dhe aksesit teknik të nevojshëm për funksionimin e stacionit të telekomunikacionit.

Gjithashtu, në lidhje me **kontratën e qirasë të lidhur ndërmjet Vodafone Albania dhe Bashkisë Maliq, të emërtuar si "1447 Zerec"**, ka rezultuar e nevojshme që sipërfaqja e kërkuar për realizimin e projektit të rishikohet, ndaj kërkojmë që të kryhet **amendimi i saj**, me qëllim ndryshimin e sipërfaqes së dhënë me qira nga **20 m² në 100 m²**, në përputhje me kërkesat teknike të projektit.

Në të njëjtën kohë, duke qenë se është përgatitur **dokumentacioni përfundimtar teknik**, i cili do të paraqitet si pjesë e dosjes për pajisjen me **leje ndërtimi**, ju lutemi të kryhet edhe **verifikimi i vendndodhjes së sipërfaqes së dhënë me qira**, në përputhje me planimetrinë dhe dokumentacionin teknik bashkëlidhur.

Në rast se nga ky verifikim rezulton ndonjë ndryshim apo përshtatje e nevojshme, kërkojmë që të kryhet edhe **amendimi përkatës i kontratës së qirasë**, në mënyrë që dokumentacioni

HELLAS SERVICE shpk
6th Klm of National Road Tirana - Durres, Kashar, Tirana - Albania
Tel: +35544503717, Fax: +35544503714
Email: hellasservice-al@hsmsgroup.com

kontraktor të jetë në përputhje të plotë me projektin teknik dhe dokumentacionin e paraqitur për lejen e ndërtimit.

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju përcjellim **dokumentacionin teknik përfundimtar**, pjesë e dosjes për pajisjen me leje ndërtimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të shqyrtimit të kërkesës sonë.

Me respekt,

Elion Mehmetaj
Menaxher i Departamentit të Implementimit të Rrjetit

CERT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 499 Prot

Maliq, më 02.02.2026

VENDIM
Nr. 19, datë 30.01.2026

"Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq"

Bazuar në ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore* "i ndryshuar; neni 8, pika 2.neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*"pika "c" ligj nr. 57/2020 "*Për pyjet*"; ligji nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkia Maliq*"; Udhëzimi nr.1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhenie ne përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*"; Këshilli i Bashkisë.

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 20 m² në ngastrën nr.39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë, Fshati Gurshqipe, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një Antene Telefonike nga kompania Vodafone Albania sh.a.
2. Ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për fillimin e procedurave për hartimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe 20 m² me objekt ngritjen e Antenës Telefonike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Bashkia Maliq nxjerr certifikatat e pronësisë të ngastrave që do jepen në përdorim dhe lidh kontratën e qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore* " i ndryshuar.

Miratuar me 22 vota
Vota Pro 22
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI





EKONOMIA PYJORE
MOGLICE

VENDODHJA E SIPËRFAQES PËR NGRITJE ANTENE NGA VODAFONE SIPAS KORDINATAVE TË KËRKESËS.

2026

Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N

LEGJENDA

EP_Moglice

N

0 2.75 5.5 11 16.5 22 Km

0 1.5 3 6 9 12 Miles